

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023*

Data: 21.03.2023

Ora:12:38

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 35, objekti “kundërshtim i vendimit nr.173, datë 21.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.
Subjekti Ankues LZHK”.**

PJESËMARRJA:

KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.


Stafi i KQZ-së: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

Parti Politike: LZHK Fabjan Topollaj

Z. E. Çefa: Mirëdita, të gjithëve! Atëherë hapim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore me nr. 35 të paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Për Zhvillim Kombëtar, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit, me nr. 173, datë 14 mars 2023. Fillimisht verifikojmë prezencën. Është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent sekretari i përgjithshëm i KQZ-së, është prezent edhe përfaqësuesi i palës ankimuese, zoti Fabjan Topollari. Meqenëse në seancën paraprake, ne i kemi konsumuar kërkesat paraprake, dhe ka rezultuar që nuk ka, besoj që nuk kemi pengesë të fillojmë direkt, duke ia dhënë fjalën fillimisht ankimuesit për të parashtruar argumentet e tij kundër vendimit të Komisionerit dhe pastaj palës së KQZ-së, të përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, për të dhënë kundërgargumentet e tij në trajtimin e kësaj çështjeje ankimore. Zoti Topollari, fjala për ju.

1

**Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023**

Z. F. Topollaj: Faleminderit! Partia LZHK, e regjistruar si parti politike me vendimin e Gjykatës së Tiranës, me nr. 3225, datë 17.07.2202, ka paraqitur kërkesën e saj për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023 në KQZ, me shkresën me numër protokolli 13/12 datë 03.03.2023. Siç parashikon edhe ligji, pjesë e kërkesës për regjistrimin e subjektit politik është i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ligji për regjistrimin e partisë politike në zgjedhjet vendore. Konkretisht, kërkesa për regjistrim përmbante, përveç kërkesës, vërtetimin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e kryetarit të partisë, si personi përgjegjës për dorëzimin e kandidatëve, emri zyrtar i partisë politike, përfaqësuesi i partisë përpara KQZ-së, financierja e partisë, deklarata solemne e kryetarit të partisë, që do të shmangë praktikat korruptive, etj. Sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor, konkretisht neni 64/2 të tij, ku kërkohet që në kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor partia politike të paraqesë të dhënat e saja, ndër të tjera, kërkohet që partia politike të paraqesë dhe emrin e saj zyrtar. Në këtë kërkesë pra ne kemi paraqitur si emër zyrtar emrin Aleanca Progresiste LZHK, emër ky që, në fakt, nuk përputhet me emrin e partisë në vërtetimin e regjistrimit të Gjykatës së Tiranës të datës 24 shkurt 2023, ku si emër i partisë figuron ende emri Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, për shkak se në bazë të vendimeve të organeve vendimmarrëse të partisë, të datës 16.02.2023, sipas parashikimeve statuore, partia e ka ndryshuar emrin e saj nga Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, në emrin e ri Aleanca Progresiste LZHK, që në 16 shkurt 2023. Këtë vendim e kemi depozituar për regjistrim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 2 mars 2023, dhe siç figuron edhe nga vërtetimi bashkëlidhur, e kam dorëzuar me kërkesën për regjistrim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo çështje është ende duke u gjykuar nga gjyqtarja Blerina Muça. Kryekomisioneri ka vendosur në mbledhjen e datës 14.05.2023 të regjistrojë partinë në zgjedhje si subjekt zgjedhor,



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023***

por me emrin e vërtetimit të gjykatës dhe jo sipas emrit zyrtar që ka kërkuar partia në kërkesën e saj për regjistrim, emër që partia paraprakisht ia ka ndryshuar sipas parashikimeve statuale të saj, të cilat kanë hyrë në fuqi menjëherë që në ndryshimin e saj më 16 shkurt 2023. Këtë vendim ne e kundërshtojmë si të pabazuar në fakte dhe në prova, dhe kërkojmë nga KAS-i të korrigjojë vendimin e Komisionerit dhe të regjistrojë partinë politike në zgjedhjet e 14 majit me emrin e saj zyrtar, që është Aleanca Progresiste LZHK. Kjo për shkak se: 1. Në bazë të statutit të partisë dhe ligjit në fuqi, emri zyrtar i partisë konsiderohet i ndryshuar që në ditën e vendimmarrjes së tij, pra më 16 shkurt 2023. Regjistrimi i ndryshimit të emrit në regjistrin e partive politike është një veprim procedural, për regjistrimin e vendimit dhe të organeve të partisë, i cili nga ana e tij nuk afekton vendimin e partisë, në këtë rast për t'u ndryshuar emrin e saj zyrtar. Vendimi i ndryshimit të emrit jep efekte që në momentin e hyrjes në fuqi dhe jo në momentin e regjistrimit në regjistër dhe sipas vendimmarrjes së organeve të partisë, që kanë bërë ndryshimin e emrit, në atë vendimmarrje shumë qartë konsiderohet që emri quhet për Partinë LZHK i ndryshuar, që në momentin e marrjes së vendimit nga ana e organeve. Kjo është arsyeja që Kodi Zgjedhor në nenin 64/2 të tij kërkon, përveç vërtetimit të regjistrimit të partisë politike në regjistrin e Gjykatës të Tiranës, edhe deklarin e emrit zyrtar të partisë për shkak se mund të ndodhë që emri i vërtetimit të gjykatës të jetë i ndryshëm nga emri i partisë për shkak se nuk është reflektuar ende në regjistër. Në gjykimin tonë, nëse veprimi i regjistrimit është automatik, pra, nëse Komisioneri e regjistron partinë politike sipas të dhënave të vërtetimit, atëherë nuk ka arsye sepse kërkohet në Kodin Zgjedhor deklarimi si i kryetarit të partisë, si i emrit zyrtar të partisë e me radhë. Në gjykimin tonë kjo ndodh pikërisht, sepse këto janë elemente deklaruese, të cilat mund të kenë ndryshim nga vërtetimi i gjykatës për shkak të

3

***Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa***



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023**

afateve procedurale apo të veprimeve të tjera procedurale që bën gjykata. Neni 64/2 i Kodit Zgjedhor kërkon vërtetimin e regjistrimit të partisë në Gjykatën e Tiranës vetëm për të provuar personalitetin juridik të subjektit zgjedhor, por jo për të përcaktuar emrin e partisë politike. Këtë të drejtë, në gjykimin tonë, e kanë vetëm organet e partisë, të cilat kanë të drejtën të ndryshojnë emrin, të ndryshojnë edhe të dhënat e tjera të partisë, të cilat në këtë rast kanë marrë vendimin për ndryshimin e emrit të partisë nga Lëvizja për Zhvillim Kombëtar në Aleanca Progresiste LZHK, që në datën 16 shkurt 2023 dhe kanë kërkuar që kjo parti të regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të 14 majit, me kërkesën e protokollit nr. 13/12 të datës 03.03.2023, me emrin e saj zyrtar në fuqi, pra, Aleanca Progresiste LZHK. Edhe një herë dua ta theksoj se ne kemi qenë shumë të qartë, që kemi kërkuar që të regjistrohemi në zgjedhje me emrin e ndryshuar prej nesh që në fillim. Pra, nuk ka pasur asnjë mëdyshje nga ana jonë, ne e kemi kuptuar ligjin kështu siç e interpretojmë, që emri i partisë nga Kodi Zgjedhor është deklarativ, pra duhet të deklarohet, sepse mund të jemi në kushtet, siç është në këtë rast subjekti politik që, pavarësisht se emri zyrtar i partisë është ndryshuar dhe ka ndryshuar edhe në statutin e partisë politike, ai nuk është reflektuar ende në regjistër. Gjithashtu, përpara se të mbyll argumentet e mia, unë mbas zbardhjes që ju i bëtë vendimit për regjistrimin e Partisë Demokratike në zgjedhje, vendim i cili është zbardhur përpara 2 ditësh, në mos gabo, gjej shumë argumente, të cilat përdoren edhe në këtë rast. Edhe një herë e them, ne kemi kërkuar që të regjistrohemi me emrin Aleanca Progresiste që në fillim, pa e marrë ju ende vendimin për regjistrimin e Partisë Demokratike, por shumë nga ato argumente janë të njëjta edhe në këtë rast. Pra, argumenti që emri i partisë dhe emri i kryetarit kërkohen si formë deklarative nga Kodi Zgjedhor, është pikërisht se mund të ndodhë që këto të ndryshojnë nga emri që ndodhet në vërtetimin

4

**Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023**

e gjykatës. Gjithashtu, argumenti që vërtetimi i gjykatës kërkohet nga neni 64 vetëm për të garantuar dhe për të shfaqur personalitetin juridik të partisë politike, pra, për të parë nëse partia politike është aktive, ka të drejtë të konkurrojë në zgjedhje, është një parti e regjistruar në gjykatë, dhe ajo nuk përcakton emrin e partisë, por qoftë edhe emrin e kryetarit, në gjykimin tonë. Shumë qartë, edhe në vendimin tuaj, ju keni arsyetuar që regjistri është vetëm një grumbullim të dhënash për të paraqitur personalitetin juridik të partisë politike dhe mund të ndodhemi, siç jemi edhe në këtë rast, që regjistri të regjistrojë një të dhënë të cilën ne e kemi ndryshuar shumë kohë më pas. A do të penalizohet partia politike që të mos i reflektohen të dhënat e saj të sakta vetëm sepse nuk janë reflektuar ende në regjistër, që është një procedurë ligjore që merr edhe kohë në këto raste? Nëse ndodh kjo e dyta, partia politike, në gjykimin tonë, penalizohet rëndë, sepse i paraqitet elektoratit me një emër që ajo nuk e konsideron të sajën. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe se në bazë të nenit 35 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, cilido ka të drejtë të mbrojë dhe të kërkojë ndreqjen e të dhënave të veta personale, si edhe faktin që emri me të cilin partia ju prezantohet zgjedhësve është jo vetëm zgjedhje e vetë partisë politike, por në asnjë rast nuk cenon interesin e garës elektorale apo interesin e ndonjë prej subjekteve të tjera elektorale në garën e 14 majit 2023, kërkojmë nga ju ndryshimin e vendimit të Komisionerit dhe regjistrimin e partisë si subjekt zgjedhor me emrin Aleanca Progresiste. Në përfundim, desha të *elaburoja* në pak sekonda parashikimet e nenit 35 të Kushtetutës, ku parashikohet mbrojtja e të dhënave personale të subjekteve, ku në pikën 4 të saj shumë qartë përcaktohet se çdo subjekt ka të drejtë që të korrigjojë në çdo kohë të dhënat e tija personale, që ai mendon që janë të pasakta. Unë mendoj që edhe ky është një nen që garanton të drejtën tonë themelore për të korrigjuar, në këtë rast, pra, emrin e partisë politike dhe partia politike të regjistrohet me emrin e



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023**

saj zyrtar. Bashkë me kërkesën për regjistrimin e partisë politike, unë kam depozituar edhe disa prova: provën e vendimmarrjes për ndryshimin e emrit të partisë politike nga organet, siç e përcakton statuti, kam depozituar një vërtetim të gjykatës që kjo çështje, me objekt ndryshimin e emrit të partisë politike, nga Aleanca Progresiste në LZHK, është ende duke u gjykuar dhe nuk është gjykuar ende nga Gjykata e Tiranës, që më 2 mars të vitit 2023. Sot kam sjellë edhe një kopje të statutit të Partisë LZHK, ku shumë qartë përcaktohet jo vetëm mënyra, se i ndryshohet emri, por edhe emri në fuqi i partisë me të cilën ne kërkojmë të regjistrohemi edhe në zgjedhje. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Po ia jap fjalën edhe sekretarit të Përgjithshëm për të parashtruar argumentet e Komisionerit për sa u tha edhe më pas, në qoftë se do të ketë pyetje nga kolegët, do të vijojmë. Po zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 14 maj 2023 ka marrë në shqyrtim kërkesën për regjistrimin e Partisë politike Lëvizja Për Zhvillim Kombëtar dhe në përfundim të procedurës administrative ka vendosur regjistrimin e Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar me germat nistore LZHK dhe me kryetar Dashamir Shehi. Në argumentimin e tij Komisioneri, duke qenë se që në fillim të marrjes në zhvillim të kërkesave të të gjithave partive politike për regjistrimin e subjektit zgjedhor, i është referuar nenit 64, pika 2, dhe konkretisht në rastin konkret germës “A”, ku vërtetimi thotë që partia është e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjiqësor. Në të gjitha vendimet e Komisionerit është mbajtur ky qëndrim, i është referuar të dhënave që figurojnë në zyrën e regjistrimit të partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Tiranë, dhe në rastin konkret në këtë vërtetim figuron që kjo parti është me



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023**

emrin Lëvizja për Zhvillim Kombëtar. Me këtë argumentim ka rrëzuar pretendimin për ndryshimin e emrit dhe ka vendosur të regjistrohet me këtë emër që figuron te regjistri. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Nga kolegët ka pyetje? Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Ndoshta mund të përgjigjen të dy edhe ankuesi, edhe sekretari i Përgjithshëm. Emri Aleanca Progresiste LZHK ka ngjashmëri me emërtimin e ndonjë subjekti tjetër politik?

Z. F. Topollaj: Jo, nuk ka asnjë ngjashmëri, madje kjo ka qenë pjesë e debatit edhe me Komisionerin, kur ai mori vendimin e tij. Ai arsyetoi që emri juaj mund të bjerë ndesh me parashikimet ligjore, siç është ngjashmëria në këtë rast, dhe shumë qartazi, nëse do të kishte ngjashmëri, janë përsëri Komisioneri dhe KQZ-ja që marrin vendim në kushtet e ngjashmërisë nëse emri i partisë politike do të reflektohet në fletë votimi apo jo. Në gjykimin tim, nuk ka asnjë ngjashmëri me asnjë subjekt tjetër zgjedhor, por edhe nëse do të ishim përpara këtij rasti, përsëri ajo është vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që emri që krijon ngjashmëri të mos përfshihet në fletën e votimit për shkak të konfuzionit që krijon. Pra, në gjykimin tonë nuk jemi në këtë rast, sepse nuk ka ngjashmëri në fillim me asnjë parti politike. Organet e partisë kanë marrë vendimin, duke pasur parasysh mos kishte ndonjë rast të ngjashëm, sepse mund të bëhej pengesë ligjore. Dhe na rezulton se nuk ka ngjashmëri me asnjë forcë politike apo parti tjetër në Republikën e Shqipërisë që ndodhej në regjistër, por edhe, nëse kjo do të ishte, përsëri është vendimmarrja e Komisionerit që e vendos nëse emri do të reflektohet ose jo në fletën e votimit sipas



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023***

parashikimeve të Kodit për të mos pasur atë konfuzionin që e parashikon shumë qartë Kodi Zgjedhor. Vetëm një saktësim dua të bëj, që e harrova në parashtrimin tim, ne kemi kërkuar vetëm ndryshimin e emrit. Nuk kemi ndryshuar shkronjat nistore të partisë politike.

Z. E. Çefa: A ka pyetje për përfaqësuesin e ankimuesit?

Z. F. Topollaj: Më falni më duket se pyetja ishte dhe për...

Z. I. Rusmali: Kjo nuk duhet të jetë korrekte, shkronjat nistore janë APLZHK, në kërkesën tuaj.

Z. F. Topollaj: Po ashtu janë, por e vërteta është që ne, në gjykatë dhe me vendim të organeve drejtuese kemi ndryshuar vetëm emrin dhe jo shkronjat nistore. Nga ana jonë, si të thuash, është bërë gabim ajo dhe ne tërhiqemi nga ajo pjesë e kërkesës.

Z. E. Çefa: Unë kisha një pyetje. Nga data e marrjes së vendimit për ndryshimin e emrit deri në datën e depozitimit të kërkesës në gjykatë, për ta pasqyruar më pas në regjistër, pashë se ka kaluar një afat kohor, nuk e kujtoj saktësisht kur ishte data e vendimit, sepse nuk e kemi të administruar.

Z. F. Topollaj: 16 shkurt.

Z. E. Çefa: Më 16 shkurt dhe e keni depozituar me 2 ose 3 mars.

***Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa***



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023**

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani besoj se është fakt i ditur botërisht procedura gjyqësore që në këtë periudhë janë pak të gjata pse e keni lënë kaq vonë? Kjo ishte pyetja ime. Pse nuk e keni çuar menjëherë brenda dite mundësisht për ta regjistruar në gjykatë vendimin e strukturave drejtuese të partisë?

Z. F. Topollaj: Unë mendoj se po të shikojmë praktikën e depozitimeve të vendimeve të organeve të partisë politike në këtë rast, pra zgjatja prej dy javësh është një kohë shumë e shkurtër, sepse për partitë politike vendimet organeve të tyre zgjasin me vite për t'i çuar. Unë kam përshtypjen se është rasti me afatin më të shkurtër të mundshëm në të gjithë historinë. Kjo ka ndodhur për shkak se është përgatitur një dokumentacion i tërë dhe i organit drejtues, i cili me 16 shkurt ka marrë vendimin, por janë përgatitur edhe një sërë dokumentacionesh, janë bërë gati për gjykatë dhe janë dërguar së bashku në gjykatë për këtë shkak pro gjithmonë para afatit për depozitimin e kërkesës së regjistrimit të partisë politike në zgjedhje.

Z. E. Çefa: Faleminderit! A ka pyetje të tjera?

Z. I. Rusmali: Nëse mund të përgjigjet edhe Ylli, sepse fjala “aleanca” është fjalë që përdoret shumë në emërtimet e partive politike, edhe fjala “progresiste” besoj se edhe kjo është fjalë që përdoret shumë. Ne nuk e kemi, por ju e keni listën e subjekteve të regjistruara në këto zgjedhje, a na krijojnë ngatërresa këto emërtime apo jo?

**Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023**

Z. Y. Merkaj: Me sa di unë janë, me sa mbaj mend unë janë disa parti politike që për fillojnë me emrin Aleanca: është Aleanca Liberale, Aleanca për Demokraci, Aleanca e Maqedonasve dhe një koalicion, i cili ka paraqitur kërkesën për t'u bërë në koalicion tri parti, që ka edhe emrin Aleanca. AL. Unë mendoj që janë të ngjashme por jo në atë masë sa të komodojë zgjedhësit për t'u ngatërruar.

Z. E. Çefa: A ka pyetje të tjera? Nuk ka. Atëherë, shkurtimisht konkluzionin: çfarë kërkoni, zoti Topollaj?

Z. F. Topallaj: Si konkluzion: kërkojmë pranimin e kërkesës sonë dhe regjistrimin e partisë politike LZHK në zgjedhje, me emrin e saj zyrtar: Aleanca Progresiste LZHK.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Rrëzimin e ankesës, lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 179, datë 14.03.2023. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! KAS-i tërhiqet pak minuta për ta diskutuar çështjen dhe për të marrë vendimin. Ndoshta 15 minuta, ose 20 minuta.

Rifillon ora: 13:24

Z. E. Çefa: "KAS-i, pasi diskutoi çështjen në tërësi, me shumicën e votave vendosi: pranimin e ankimit, ndryshimin e vendimit nr. 173, datë 14 mars 2023 të



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 21.03.2023***

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të regjistrojë si subjekt zgjedhor partinë politike Aleanca Progresiste LZHK, me kryetar zotin Dashamir Shehi dhe me germa nistore LZHK”. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare të KQZ-së kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 30

***Zbardhi materialin audio
Eneida Stefa***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

Data 21.03.2023

Ora 13:26

RENDI I DITËS

Projektvendim “Shqyrtimi i Kërkesës Ankimore nr. 36, objekti “kundërshtim vend. Nr. 179, dt.18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Subjekti Ankues Partia Demokratike (Sali Berisha)

PJESËMARRJA:

1. KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

2. Stafi i KQZ: Z. Y. Merkaaj, Znj. E. Mema, Z. I. Osmanaj

PARTI POLITIKE: PD (I. Sefa) (L. Nuraj, F. Nuri)

KRIIK

Z. L. Braho: Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 36, të depozituar në KQZ, më datë 20 mars 2023, ora: 15:00. Kërkesë ankimore depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë me objekt ankimi: kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 179, datë 18 mars 2023, dhe ndryshmin e këtij vendimi duke vendosur pezullimin e regjistrimit të subjektit Partia Demokratike, me nënkryetar zotin Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar, për zgjedhjet e për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj të vitit 2023, deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar për ankimin e subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga kryetari, zoti Sali Berisha. Kush është i pranishëm për ankimuesin?

1

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023**

Z. F. Nuri: Franci Nuri.

Z. L. Nuraj: Ledio Nuraj.

Z. L. Braho: Për administratën e KQZ-së është sekretari i Përgjithshëm, zoti Ylli Merkaj. Zoti sekretar i Përgjithshëm, a ka ndonjë kërkesë për palë të tjera pranë KQZ-së në këtë proces ?

Z. Y. Merkaj: Pranë protokollit të KQZ-së është paraqitur një kërkesë për ndërhyrje, si palë e interesuar në këtë proces, nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe përfaqësuar nga zoti Indrit Sefa.

Z. L. Braho: Dakord. Faleminderit! Atëherë, KAS-i, i konsultuar në vend, vendos: pranimin e kësaj kërkesë dhe përfshirjen si palë e interesuar në këtë proces të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Indrit Sefa. Atëherë, shkurtimisht, zoti sekretar i Përgjithshëm, çfarë përmban ankimi dhe a i plotëson kriteret dhe elementet sipas nenit 130 të Kodit Zgjedhor?

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendim nr. 179, datë 18.03.2023, ka marrë në shqyrtim vendimin për zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.03.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj të vitit 2023. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari, zoti Sali Berisha. Nga verifikimi i elementeve formale të kërkesës, konstatohet se kërkesa e parë kompetencë e KQZ-së për shqyrtimin e



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023**

ankimit është e plotësuar. Legjitimitimi i ankuesit nuk e plotëson këtë pikë dhe e sheh këtë tek afati kohor i ankimit. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Kush nga përfaqësuesit e ankimuesit do të flasë?

Z. L. Nuraj: Do të flasim të dy pasi, duke qenë se kemi qenë të njoftuar për orën 13, dhe jemi gati me një orë e gjysmë vonesë në këshillimin e seancës nga ora e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Z. L. Braho: Po, pra, gjysmë ore, jo një orë e gjysmë.

Z. L. Nuraj: Jemi njoftuar në orën 13, ora është një e gjysmë.

Z. L. Braho: Po pra, thatë që jemi me vonesë një orë e gjysmë.

Z. L. Nuraj: Po nga që keni qenë me vonesë gjysmë ore. Kështu që unë do të vazhdoj, sepse ka dalë një problem më i rëndësishëm, kështu që do të vazhdojë Franci Nuri se jemi dhe në fushatë.

Z. I. Braho: Po, zoti Nuri, fjala për ju, lidhur me kriteret në zbatim të nenit 130.

Z. F. Nuri: Atëherë, vazhdojmë, përderisa koha është e çmuar të mos ju marrim më tepër kohë. Pa dashur ta paragjykoj vendimmarrjen tuaj edhe pse mund ta dimë shumë mirë si do të shkojë kjo punë ne e bëmë thjesht për çështje procedurale.

**Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023**

Z. L. Braho: Zoti Nuri, tani këto etiketimet mund t'i lësh. Pra, vazhdoni. Ju dhashë fjalën për nenin 130, jo se çfarë pret ti nga KAS-i, çfarë pret ti nga KAS-i thuaje në fund.

Z. F. Nuri: Aty doja të dilja, i nderuar, do të thosha e kemi bërë për procedurë për shkak se ne mendojmë që jemi palë e legjitimuar që të kërkojmë pezullimin e një vendimi, në gjykimin tonë të padrejtë, ndaj të cilit kemi paraqitur ankim edhe në Kolegjin Zgjedhor. Dje në ankimin ndaj vendimit të Komisionerit Celibashi kemi paraqitur si provë dhe depozitimin në Kolegjin Zgjedhor të kërkesës së nënshkruar nga zoti Sali Berisha, ku kërkohet patjetër çregjistrimi i vendimit të mëparshëm të KAS-it dhe rregullimi i pasojave. Në gjykimin tonë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet ta kishte marrë në konsideratë kërkesën, por, më keq se kaq, Komisioneri vazhdon me metodën e tij të punës, a nuk e di, që nuk e pasqyron fare nuk e evidenton fare në vendimet e tij, as nuk e relatton kërkesën që ne i kemi paraqitur. Unë, personalisht, në seancën e ditës së shtunë, 18 mars kam kërkuar shprehimisht për procedurë pezullimin e vendimmarrjes me arsyetimin: që afati i ankimit në KAS nuk kishte kaluar, pala e cenuar ishte duke përgatitur ankim në Kolegj. Dhe shoh se vendimmarrja e këtij vendimi të Komisionerit për të cilin ne jemi sot këtu nuk është pasqyruar fare në vendim, nuk ka asnjë rresht në vendimin e Komisionerit ku të shkruhet kjo që unë kam thënë në seancë, jo me të ketë dalë me vendim dhe të thotë që dakord unë e rrëzoj ose e hedh poshtë për iks arsye. Kjo është e përsëritur, sikundër edhe ju të nderuar anëtarë të KAS-it e vutë re edhe në seancat e mëparshme, që kemi pasur, që Komisioneri nuk i ka ndjekur udhëzimet që mund të jenë dhënë në lidhje me kthimin e të gjitha përgjigjeve ndaj kërkesave që janë drejtuar. Kështu që përfundimisht ne kërkojmë që të kalojë çështja në seancë

4

**Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023**

themeli për sa kohë ne jemi si palë e prekur nga vendimi dhe zbatimi i vendimmarrje së zotit Celibashi. Patjetër ai e ka marrë këtë vendim bazuar në vendimin e KAS-it, por, për sa kohë Kolegji Zgjedhor është instanca që do të shprehet në formë përfundimtare për gjykimin e të gjithë konfliktit, po themi në themel, dhe për sa kohë Kolegji nuk është shprehur ende tani në orën 2 e gjysmë, është duke u hedhur shorti, ne gjykojmë se kjo çështje, pra regjistrimi i Partisë Demokratike në zgjedhje, pavarësisht me cilin kryetar, mendojmë se duhet të presë deri sa të zgjidhet në formën përfundimtare. Në të kundërt çfarë kuptimi ka? Bëhet një regjistrim sot dhe pastaj ne të ankohemi për një gjë më vonë? Të kërkojmë çregjistrimin më vonë? Dakord.

Z. L. Braho: Faleminderit, fjala për ju, zoti Sefa, si person i interesuar.

Z. I. Sefa: Në bazë të nenit 130 shkronja “b” ankuesi nuk është subjekt zgjedhor, parashikuar edhe në nenin 2 pika 20 që bën përkufizimin se cilat janë subjektet zgjedhore. Gjithashtu, edhe legjitimimi i përfaqësuesit të ankuesit në këtë proces duhet bërë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Civil. Nuk mundet një person natyral të lëshojë autorizim, por ai mund të përfaqësohet vetëm me prokurë, për sa kohë që vendimmarrja e KAS-it dhe e Komisionerit ka përcaktuar qartë se cili është subjekti zgjedhor dhe kush e përfaqëson subjektin zgjedhor. Edhe përfaqësuesit e ankuesit për këtë duhet të kenë tagrat e përcaktuara qartë me anë të prokurës së posaçme. Nuk ka ankim nga Partia Demokratike e Shqipërisë, por ka nga një individ natyror, i cili pretendon që e përfaqëson, ndaj dhe këto kërkesa duhet të trajtohen në mënyrë formale, siç e përcakton ligji. Partia Demokratike e Shqipërisë nuk përfaqësohet nga ankuesi dhe as nga përfaqësuesit e



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023**

ankuesit, ndaj ne mendojmë që kjo kërkesë nuk duhet të kalojë fare në seancë shqyrtimi nga ana e KAS-it. Nuk plotëson kushtet formale për t'u pranuar Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! A ka pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Pala e interesuar thotë se nuk legjitimoheni, KQZ-ja thotë nuk legjitimoheni; të dyja, me sa kuptova, për shkak se nuk figuron si subjekt zgjedhor. Argumenti juaj pse legjitimoheni, përtej përmbajtjes se nuk na duhet, pra pse legjitimoheni? Shumë shkurt që të jetë e qartë edhe për ne.

Z. I. Sefa: Legjitimohemi për sa kohë kemi kërkuar, unë kam kërkuar personalisht në vendimmarrjen, para se Komisioneri të merrte vendimin e tij të shtunën, kam kërkuar pezullimin e regjistrimit të Partisë Demokratike si subjekt, e përfaqësuar me nënkryetarin, zotin Alibeaj, për sa kohë nuk është shprehur Kolegji Zgjedhor. Duke qenë se Komisioneri nuk e ka marrë fare në shqyrtim këtë çështje, nuk e ka pasqyruar fare në vendim, pra e ka injoruar, sepse mund të kishte dalë edhe duke e rrëzuar, si kërkesë. Pra, fakti që nuk e ka marrë në konsideratë këtë kërkesë, po ankoem për këtë gjë.

Z. I. Rusmali: Në seancën e zhvilluar nga Komisioneri për marrjen e vendimit nr.179, ju keni qenë të përfshirë si palë në atë seancë? Na e shpjegoni pak.

Z. F. Nuri: Unë kam qenë edhe me autorizim të koalicionit, si përfaqësues i koalicionit "Bashkë fitojmë", por njëkohësisht isha edhe përfaqësuesi që kisha marrë

**Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ**



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023***

pjesë edhe në gjykimin që u bë në KAS, edhe me autorizim nga zoti Berisha për të ndjekur procedurën në KQZ. Aty kam folur me të dy.

Z. I. Rusmali: Pra, e ka diskutuar Komisioneri çështjen e legjitimitimit në atë seancë, jo këtu, atje është bërë ky diskutim? Keni marrë fjalën, keni dhënë pretendimet tuaja, nuk ka rëndësi, i ka konsideruar, nuk i ka konsideruar, kjo është temë tjetër, ju keni pasur mundësi të flisnit lirisht e të mbanit qëndrim lidhur me objektin e shqyrtimit, që ishte regjistrimi.


Z. F. Nuri: Më është dhënë fjala nga Komisioneri dhe kam shpjeguar shkurtimisht këtë gjë që po jua shpjegoj edhe juve, pra, duke i thënë që jam këtu në cilësinë e përfaqësuesit, si palë e interesuar apo ankues që ka qenë prezent në vendimmarrjen nr. 27 tuajën dhe me këtë rast kërkoj nga Komisioneri pezullimin e vendimmarrjes për regjistrimin e Partisë Demokratike, përfaqësuar me nënkryetarin Alibeaj, për sa kohë pala tjetër është duke bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor nuk është shprehur ende e të tjerë, e të tjerë. Pra, në ankim prandaj kemi sjellë enkas edhe provën e paraqitjes në Kolegjin Zgjedhor, pra e kemi ushtruar efektivisht të drejtën e ankimit në Kolegj, se mbase nuk e vendosim dot brenda 5 ditëve, e kemi bërë, e kemi paraqitur si provë për të thënë që kemi interes të ligjshëm që kjo çështje të presë derisa të marrë zgjidhje përfundimtare në rrugë gjyqësore.

Z. L. Braho: KAS-i do të tërhiqet për vendim, besoj për 10 minuta.

Rifillon, ora 13.51

Z. L. Braho: Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 36. KAS-i, pasi dëgjoi pretendimet e palës ankuese, prapësimet e Sekretarit të Përgjithshëm të

***Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ***




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të palës së interesuar Partia Demokratike e Shqipërisë, që përfaqësohet nga zoti Indrit Sefa, vendosi: Në zbatim të nenit 129, pika 3, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 36 të depozituar në KQZ në datën 20 mars 2023. Seanca për shqyrtimin administrativ të kësaj kërkesë ankimore do të jetë në datën 23 mars, ora 13:00. E deklarojmë të mbyllur këtë seancë.

Vendimi nr. 31

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

21.03.2023
Ora 13.56

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 37, objekti
“Kundërshtimi i vendimit nr.178, datë 18.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve”, subjekti ankues PD”.*

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj.
- **Parti politike** PD I. Sefa, F. Nuri

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve. Fillojmë seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 37, të depozituar në KQZ në datën 21.3.2023 me subjekt ankimues Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Indrit Sefa, kundër vendimit nr.178, datë 18.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë fitojmë” në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Nga shorti i hedhur sot në KQZ relator i kësaj kërkesë jam caktuar unë Elvis Çefa. Verifikojmë prezencën. Është prezent KAS, është prezent përfaqësuesi i subjektit ankimues, zoti Indrit Sefa me autorizim, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, i cili përfaqëson Komisionerin në këtë procedim administrativ. Kërkesa paraprake a ka? Nuk ka. Nga kolegët a ka ndonjë deklaratë paraprake? Nuk ka. Kështu që mund të vijojmë pa

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 1

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

pengesa për të dëgjuar relativisht shkurtimisht të Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së e më pas ankimuesit.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 18.3.2023 ka marrë në shqyrtim kërkesën për regjistrimin e koalicionit “Bashkë fitojmë” me kërkues katër parti politike: Partia Lëvizja e Lirisë, Partia Demokratike e Shqipërisë, Partia Demokristiane e Shqipërisë dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Në përfundim të shqyrtimit administrativ me arsyetimin se Partia Demokratike e Shqipërisë me kryetar zotin Sali Berisha nuk përmbush kriteret e nenit 65, pika 1, të Kodit Zgjedhor, pasi nuk rezulton si subjekt zgjedhor dhe si i tillë nuk mund të jetë pjesë e këtij koalicioni, ka regjistruar koalicionin “Bashkë fitojmë” me përbërjen e tri partive politike dhe subjekte zgjedhore njëkohësisht: Partia Lëvizja e Lirisë, Partia Demokristiane e Shqipërisë dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Partia Demokratike e Shqipërisë me përfaqësues zotin Indrit Sefa, i cili e ka ankimuar dhe e ka depozituar kërkesën në KAS. Nga shqyrtimi i kërkesës ankimore konstatohet se i plotëson të tria elementet e nenit 130 të Kodit Zgjedhor, elementet si: kompetenca e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit, legjitimitimi i ankuesit dhe respektimi i afateve ligjore për ankim. Për këto arsye propozojmë të kalohet për shqyrtim. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Shkurtimisht zoti Sefa të na parashtojë pretendimet në këtë fazë të procedimit.

Z. I. Sefa: Shkurt, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Në bazë të dispozitave ligjore dhe Kodit Zgjedhor përcaktohet fare qartë si një element i rëndësishëm dhe pjesë e dokumentacionit shoqërues për kërkesën për

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

regjistrim koalicionesh është edhe marrëveshja midis partive politike. Në këtë marrëveshje është referuar edhe Partia Demokratike e Shqipërisë me kryetar zotin Sali Berisha. Ne mendojmë që Komisioneri do ta kthente këtë marrëveshje, nuk do të merrte rol aktiv për ta regjistruar menjëherë me ndryshimet përkatëse të tij, por duhet ta kthente këtë marrëveshje për plotësim dokumentacioni duke referuar faktin që duhet të hiqej ankronimi ose të mos jetë fare pjesë e kësaj marrëveshjeje emri Partia Demokratike e Shqipërisë. Siç kemi relatuar edhe gjatë fazës kur Komisioneri ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë, Partia Demokratike e Shqipërisë nuk ka asnjë marrëveshje të tillë për të hyrë në koalicion me këto parti, rrjedhimisht Partia Demokratike nuk është pjesë e kësaj kërkesë për regjistrim si koalicion. Duke qenë se marrëveshja është pjesë integrale e dokumentacionit shoqërues dhe është pjesë përbërëse e tij, Komisioneri nuk mund të ketë rol aktiv për të hequr emrin e Partisë Demokratike, por duke lënë marrëveshjen në fuqi. Ne mendojmë që ky vendim i Komisionerit është marrë në kapërcim të dispozitave të ligjit dhe kompetencave të tij, ndaj ne mendojmë që KAS-i duhet ta kthejë për rishqyrtim pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke lënë detyra konkrete dhe, pasi të marrë vendimin e KAS-it, Komisioneri të orientojë subjektet që kanë bërë kërkesë për regjistrimin e këtij koalicioni të bëjnë rregullimin përkatës duke hequr emrin e Partisë Demokratike të Shqipërisë nga kjo marrëveshje. Kjo marrëveshje përcakton disa pika dhe përcakton fare qartë edhe detyrat dhe mënyrën e organizimit të partive, pjesë përbërëse të saj. Siç referohet edhe në pikën 3 të kësaj marrëveshjeje, drejtuesja politike e koalicionit është Partia Demokratike e Shqipërisë. Në asnjë rast nga ana jonë nuk është referuar që ne jemi pjesë e këtij koalicioni dhe si rrjedhojë kjo marrëveshje nuk mund të bëhet pjesë integrale e dokumentacionit për regjistrimin e këtij koalicioni. Ne jemi koshientë për një vendimmarrje të mëparshme të KAS-it të vitit 2022, por në rastin konkret këtu kemi shprehimisht termin “Partia Demokratike

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 3

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

e Shqipërisë”, ndërkohë në rastin e mëparshëm referohet si Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. Ndaj ne mendojmë që kjo është një kërkesë e pranuar nga ana e Komisionerit, ka të meta thelbësore, të cilat duhet të korrigjohen nga kërkuesit. Për sa më sipër kërkoj kalimin në seancë shqyrtimi, ku të paraqesim më shkrim edhe të gjitha pretendimet ku ne bazojmë kërkesën tonë. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit, zoti Sefa! Pyetje nga kolegët? Nuk ka. Unë kam një pyetje formalisht. Praktikisht në tekstin e vendimit Partia Demokratike nuk është përmendur në asnjë vend dhe ky është akti që godisni formalisht me ankimin tuaj, ndërkohë nga shpjegimet tuaja në seancë unë kuptoj që ju në vetvete me vendimin nuk keni ndonjë mosdakordësi, por e keni me deklaratën, pra me një dokument që i ka shërbyer Komisionerit apo i ka shërbyer më tepër, në fakt, koalicionit për të paraqitur çështjen përpara Komisionerit, por të cilin Komisioneri nuk e ka marrë në konsideratë për efekt të marrjes së vendimit. Apo jo?

Z. I. Sefa: I nderuar anëtar, patjetër që vendimmarrja e Komisionerit ka marrë rol aktiv duke hequr emrin e Partisë Demokratike, por po them që në bazë të dokumentacionit të paraqitur për regjistrimin e koalicionit zgjedhor pranë Komisionerit është edhe marrëveshja. Marrëveshja është një dokument thelbësor që ndan mënyrën e funksionimit midis partive politike dhe po t’i referohemi pikës 7 të marrëveshjes thotë: “Në listat shumemërore të këshilltarëve të koalicionit zgjedhor do të përfshihet çdo parti e këtij koalicioni, numri i kandidatëve dhe renditja e tyre bazuar në marrëveshje midis palëve. Kandidatët në listat shumemërore të koalicionit, pavarësisht se cilës parti i përkasin, do të konsiderohen e vlerësohen kandidatët vetëm të koalicionit duke shmangur përcaktimin (minuta 40.40) sipas përkatësive partiake.”. I referohemi kësaj marrëveshjeje. Nënkuptohe dhe kuptohet që në këtë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



4

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

marrëveshje do të jenë edhe përfaqësues të Partisë Demokratike, ndaj ne themi që marrëveshja nuk është thjesht nga ana formale, por është një dokument thelbësor i kërkesës për regjistrim. Edhe në bazë të vendimmarrjeve të mëparshme të tij, rezulton që Komisioneri e bën leximin e Kodit në germë dhe jo në frymë, ndaj ne mendojmë që Komisioneri ka tejkaluar kompetencat duke e regjistruar menjëherë e duke marrë rol aktiv. Komisioneri duhet t'i linte kohë subjektit zgjedhor për ta rregulluar dhe, pasi ta rregullonim, mund të kishim edhe ndryshime të termave të marrëveshjes. Kjo është edhe për ne problematika kryesore në lidhje me këtë vendimmarrje të tij. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: E njëjta pyetje. Në seancën e shqyrtimit nga Komisioneri, siç rezulton edhe nga vendimi, ju keni marrë pjesë. Në çfarë cilësie keni marrë pjesë aty?

Z. I. Sefa: Si përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe jam referuar në disa momente disa herë si përfaqësues i përhershëm i Partisë Demokratike të Shqipërisë, i kam konfirmuar që Partia Demokratike e Shqipërisë nuk ka asnjë marrëveshje me parti të tjera për të hyrë në koalicion. I kam kërkuar Komisionerit rrëzimin e kërkesës në atë seancë publike. Komisioneri referoi që ka një praktikë të ngjashme të ndjekur më parë, por nuk është rasti specifik, sepse në rastin e mëparshëm Partia Demokratike përfaqësohej nga Komisioni i Rithemelimit, ndërsa në këtë rast kemi të bëjmë me emrin ekzakt të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

Z. I. Rusmali: Pse marrëveshja cenon interesat tuaja të ligjshme?

Z. I. Sefa: Siç referova, në pikën 7 marrëveshja thotë që do të ketë kandidatë nga çdo parti politike, që është pjesë e koalicionit dhe Partia Demokratike e Shqipërisë e konfirmon përsëri përpara KAS-it nuk do të ketë asnjë kandidat të saj në listën e këtij koalicioni. Kandidatët e Partisë Demokratike do të jenë në listën e saj zyrtare, që do të paraqitet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisionit Zonal Zgjedhor. Partia Demokratike e Shqipërisë nuk është pjesë e këtij koalicioni dhe nuk mund të referohet kurrsesi si pjesë e këtij koalicioni. Në zbatim të saj, nesër mund të ngrihet që ky koalicion mund të referojë kandidatët dhe të thonë që janë pjesë e Partisë Demokratike të Shqipërisë si pjesë e listës përbërëse, por realisht në asnjë rast Partia Demokratike e Shqipërisë nuk është pjesë e këtij koalicioni, ndaj ne mendojmë që edhe marrëveshja është pjesë thelbësore e kërkesës për regjistrim të këtij koalicioni. Ndaj ne mendojmë që minimalisht ajo duhet ndryshuar, por kërkesa jonë ka qenë për rrëzim të Komisioneri. Minimalisht KAS-i duhet t'ia çojë për rishqyrtim Komisionerit, ku t'u lërë kohë palëve kërkuuese për të plotësuar të metat dhe të sjellin një marrëveshje të re.

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera nuk ka. Ne do t'ju kërkojmë sërish pak minuta kohë, në mënyrë që të diskutojmë e t'ju njoftojmë.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.03.2023*

Rifillon

Ora 14.21

Z. E. Çefa: KAS-i, pasi e diskutoi çështjen në tërësi, vendosi me shumicën e votave moskalimin për shqyrtim në seancë të themelit të kërkesës ankimore nr. 37, paraqitur nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë, me përfaqësues me autorizim zotin Indrit Sefa. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet rregullisht ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 32

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

